



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:082256

Datë: 24.09.2021

Numri i dokumentit: 02208245

P.nr.288/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. D. nga Gj..... për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Ymer Huruglica nga Gjilani si dhe të pandehurit L. K. nga Gj.. për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Egzon Halimi nga Gjilani duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr..../19 të datës 22.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë 05.08.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 24.09.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. E.. D., nga babai M., nëna N., e lindur K., i lindur me datë ....., në Gj., ku edhe tani jeton në rrugën “D. Sh.”, banesa e parë, Kati .., nr... student në fakultetin juridik “K. Z.” në Gj... i martuar babai i .. fëmije, i punësuar në K.. M., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe
2. L. K., nga babi A., nëna L., e lindur Q....., i lindur me datë ....., në Gj., ku edhe tani jeton në rrugën “Xh. T.”, nr., ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i pamartuar, i papunë, i gjendjes në varfër ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës,

## JANË FAJTOR

### I.

I akuzuari E. D..

Sepse prej muajit prill të vitit 2018 e deri në muajin janar të vitit 2019, në lokalin për “A. P. P.” që ndodhet në rrugën qarkore në Gj. i pandehuri E. D. në cilësinë e shitësit me dashje dhe me qëllim që vetes ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror ka keqpërdorur autorizimet e tij ashtu që nuk i ka përmbushur obligimet e tij duke tejkaluarat autorizimet dhe shitur pjesë të automjeteve me çmime më të larta, duke inkasuar të holla më shumë ndërsa ka faturuar më pak kështu që i pandehuri me veprimet e tij duke shfrytëzuar autorizimin e dhënë për përfaqësimin e interesave pasurore të të dëmtuarit, ka ndërmarrë veprime që nuk janë në interes të personit të cilin e përfaqëson duke e dëmtuar të dëmtarin në vlerë të pa përcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga nenit 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës,

### II.

I akuzuari L..K.,

Sepse prej muajit tetor të vitit 2018 e deri në muajin janar të vitit 2019, në lokalin për “A. P. P.” që ndodhet në rrugën qarkore në Gj. i pandehuri L. K. në cilësinë e shitësit me dashje dhe me qëllim që vetes ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror ka keqpërdorur autorizimet e tij ashtu që nuk i ka përmbushur obligimet e tij duke tejkaluarat autorizimet dhe shitur pjesë të automjeteve me çmime më të larta, duke inkasuar të holla më shumë ndërsa ka faturuar më pak kështu që i pandehuri me veprimet e tij duke shfrytëzuar autorizimin e dhënë për përfaqësimin e interesave pasurore të të dëmtuarit, ka ndërmarrë veprime që nuk janë në interes të personit të cilin e përfaqëson duke e dëmtuar të dëmtuarin në vlerë të pa përcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga nenit 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës

Andaj gjykata në bazë të neneve 4,41,42,43,45,46,47,73 dhe 74 të KPRK-ës dhe neneve 359,360,361,362 dhe 365 të KPP-ës të akuzuarit e lartcekur:

## I GJYKON

Të akuzuarin E. D. për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e tij dhe komfor nenit 47 të KPRK-ës i ZËVËNDËSOHET në dënim me gjobë në shumë prej 2000 € (dymijë euro), të cilat shuma do të ekzekutohen në afat prej 3 (tre) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa

Të akuzuarin L. K. për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e tij dhe komfor nenit 47 të KPRK-ës i ZËVËNDËSOHET në dënim me gjobë në shumë prej 2000 € (dymijë euro) të cilat shuma do të ekzekutohen në afat prej 3 (tre) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje të paguajnë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari F.. R.. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen të akuzuarit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimin, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcenim të përmbartimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 25.03.2019 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr...2020 kundër të akuzuarit E. D. nga Gj.. për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së si dhe të pandehurit L. K. nga Gj. për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilat seanca është bërë administrimi i provave personale dhe materiale si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se pas shtjellimit dhe administrimit të gjitha provave si ato materiale dhe ato personale, dëgjimit të pandehurve, të dëmtuarit dhe dëshmitarëve u vërtetua se të pandehurit E. D. dhe L.K. i kanë kryer veprat penale siç janë të përshkuara në dispozitivin e aktit akuzues dhe se dyshimi i bazuar mirë mbështetet në provat, deklaratat e të pandehurve, dëshminë e të dëmtuarit F. R., deklaratën e dëshmitarit F. J. si dhe shkresat e tjera të lëndës, se të pandehurit i kanë kryer këto vepra penale vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarit F. J. i cili ka deklaruar se kur kishte blerë pjesë tek “A. P. P.” në Gj. kishte kuptuar se në pjesët që kishte blerë pagesa kishte qenë e ndryshme, po ashtu edhe i dëmtuari F. R. kishte deklaruar se të pandehurit kishin bërë manipulime dhe mashtrime të klientëve ngase kanë shitur produkte me çmime më të larta ndërsa i kanë faturuar me çmime më të ulëta dhe se kjo është vërejtur edhe nga kamerat e sigurisë dhe se i dëmtuari ka kërkuar nga të pandehurit që të shkojnë tek noteri që të njëjtit t’ia kompensojnë dëmin mirëpo të njëjtit nuk kanë pranuar, me tutje prokurori i shtetit ka deklaruar se të pandehurit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre mirëpo i kanë keqpërdorur autorizimet me qëllim që realizojnë për vete apo për tjetrin dobi pasurore të kundërligjshme dhe se të njëjtit nuk e kanë pranuar fajësinë për ti ikur përgjegjësisë penale andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ti merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë që dënimi të jetë proporcional me dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit F. R. avokati Durim Nevzati nga Prizreni në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas shqyrtimit të provave personale dhe materiale është vërtetuar se nga veprimet e të akuzuarve janë formuar elementet e veprës penale të cilat iu vihen në barrë të akuzuarve, më tutje ka shtuar se i dëmtuari përmes video incizimet e ka kuptuar se fillimisht i akuzuari E. e pastaj edhe i akuzuari L.. kanë manipuluar me sistemin nëpërmjet së cilit i ofrohen shërbime klientëve përkatësisht personave fizik dhe atyre juridik, që do të thotë se personat juridik kanë pasur çmimin më të ulët atë të shumicës ndërsa personat fizik kanë pasur çmimin më të lartë, po ashtu dëshmitari F. J.. ka deklaruar se nuk është e vërtetë se mekaniku A... i ka thënë ai do ti blejë pjesët pasi që i merr më lirë për shkak se është mekanik pasi që dëshmitari F.. kur e ka blerë pjesën e veturës ka qenë në vlerë 100 euro ndërsa për të njëjtën pjesë mekaniku A.... e ka pranuar faturën në vlerë prej 91.8 euro, më tutje përfaqësuesi i të dëmtuarës ka deklaruar se manipulimet e të akuzuarve shihen edhe nga video incizimet ku të akuzuarit produktet i shesin me çmim më të lartë ndërsa i faturojnë me çmim më të ulët dhe se këtë diferencë e kësaj e kanë mbajtur për vete si dobi pasurore dhe se pa dyshim ndaj të njëjtëve formohen elementet e veprës penale e cila iu vihet në barrë ngase është vërtetuar se të njëjtit kanë qenë të pajisur me kontratë të punës dhe kanë pasur në shfrytëzim arkën e afarizmit të të dëmtuarit dhe të njëjtit e kanë shfrytëzuar besimin me të cilin i ka ngarkuar i dëmtuari ashtu që të njëjtit në vazhdimësi kanë përvetësuar diferenca të ndryshme dhe se të njëjtit në mbrojtjen e tyre kanë pretenduar që ti shmangen përgjegjësisë penale.

I dëmtuari F. R. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe të përfaqësuesit të tij dhe se nga dita kur ka ndodhur rasti e deri më sot imazhi i firmës së tij ka rënë dhe se nuk po mundet ti ri kthejë klientët ngase të njëjtit nuk kanë besim.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. D., avokati Ymer Huruglica në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar nuk është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se i njëjti 3 vite ka punuar tek e dëmtuara asnjëherë nga i autorizuari i të dëmtuarës nuk e ka pasur asnjë vërejtje të vetme por me datë 13 janar 2019 të akuzuarit vetëm janë njoftuar se nuk janë më punëtor të asaj pike të shitjes me arsyetimin se kanë bërë disa keqpërdorime gjatë procesit të punës. Më tutje ka deklaruar se pretendimet e të dëmtuarit F. R. sa i përket shikimit të kamerave të sigurisë të cilat kanë qenë të vendosura në pikën e shitjes në Gjilan i njëjti ka vërejtur pa rregullsi nuk janë të pranuar sepse nuk janë të mbështetura në fakte dhe në dhe prova të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore sepse çmimet e shitjes sipas këtij dëshmitari asnjëherë nuk ka qenë të njëjta përkatësisht tjetër çmim i është ofruar personit juridik e tjerë atij fizik, po ashtu duke iu referuar provës materiale të ofruar nga ky dëshmitar të gjitha pro faturat janë të pa nënshkruara dhe të pa vulosura nga i mbrojturi i tij dhe se ato nuk janë të përpiluara nga ai sepse në çdo pro faturë, ofertë apo faturë tatimore të cilat i ka përpiluar i mbrojturi i tij janë të nënshkruara nga i njëjti dhe se dëshmitari F. J. nuk ka vërtetuar ndonjë keqpërdorim ndaj të akuzuarve. Po ashtu nga video incizimet në kamerat e sigurisë vërehet se i dëmtuari F...i kërkon një punëtor që të bëhet zbritja e një fature në vlerë më të madhe dhe ti jepet kupon fiskal vetëm atyre që nuk i njohin dhe se i akuzuari Leutrim vërteton faktin se në kompjuterin e tij dallimet në përpilimin e një pro fature ose oferte dhe faturë tatimore është bërë përmes një dritare të programit e cila ka qenë e quajtur “A..e sh...” ndërsa diferenca e shumës e cila ka qenë në dritaren tjetër është quajtura “në të zezë” e cila është bartur me një zarf me paragon bllok të thjeshtë dhe përmes shoferit është transportuar tek pronari i të dëmtuarës.

I akuzuari E... D.. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit L... K..., avokati Egzon Halimi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer këtë veprë penale dhe se nga provat e paraqitura asnjëri prej të akuzuarve nuk inkriminohen për veprat penale për të cilat akuzohen, po ashtu faturat e paraqitura gjatë procedurës së provave është vërtetuar se kanë mospërputhje njëra me tjetrën për shkak të dallimeve të klientëve në shitjen e produkteve për persona

fizik dhe juridik dhe se pro faturat e bashkangjitura në video incizime nuk janë asnjë formë dëshmi se është keqpërdorur në dëm të kompanisë apo në dobi të mbrojturit të tij, sa i përket se i mbrojturi i tij i ka futur paratë e pazarit në xhep kjo nuk ka mundur të ndodhë për faktin se punëtorët kanë pasur të drejtë të gjejnë zgjidhje në rastet kur nuk kanë pasur para tua kthenin kusurin klientëve

I akuzuari L. K.. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër.

## 2. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë në bazë të:

- Dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit F. R.,
- Dëgjimit të dëshmitarit S.H...,
- Dëgjimit të dëshmitarit F.. J..
- Leximin dhe administrimin e provave materiale si: raporti informues i incidentit me numër të rastit 2019-CA-... i datës 4 shkurt 2019, deklarata e të pandehurit E.. D.. e dhënë në polici me datë 25.01.2019, deklarata e të pandehurit L. K. e dhënë në polici me datë 22.01.2019, deklaratat e të dëmtuarit F.R. të dhëna në polici me datë 22.01.2019 dhe datës 16.01.2019, raporti i zyrtarit policor S.H. me numër 2019-CA-..... i datës 30.01.2019, deklarata e dëshmitarit F.. J. e dhënë në polici me datë 22.01.2019, aktvendimi mbi regjistrimin e malit i datës 27 janar 2019, fatura tatimore e datës 29.10.2018, fatura tatimore e datës 16.10.2018, fatura tatimore e datës 13.10.2018, kontrata e punës e lidhur ndërmjet “A. P. P...” Sh.p.k dhe L. K. e datës 01.10.2018, kontrata e punës e lidhur ndërmjet “A.P. P.” Sh.p.k dhe E.D.i e datës 01.08.2017, raporti i oficerit A.J.. i datës 16.01.2019, një CD me video incizim, libri i kasës i muajit nëntor të vitit 2018 i “A. P. P.” Sh.p.k, libri i arkës për muajin nëntor 2018 i “A. P. P.” Sh.p.k, pesë faturat të datës 11.06.2019, emaillet e komunikimit ndërmjet F. R. dhe të akuzuarve dhe punëtorëve të tjerë për t’iu udhëzuar se si të veprohet me zbritje në produktet e caktuara.
- Mbrojtja e të akuzuarit E. D. dhe
- Mbrojtja e të akuzuarit L. K.

### 2.1. Deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit F. R.

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit F. R. në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratave të dhëna në polici dhe se është pronar i “A. P. P.” Sh.p.k, të akuzuarit i njeh dhe të njëjtit kanë qenë punëtor me kontratë në firmën e tij dhe se i njëjti iu ka thënë se i mbron interesat e firmës dhe ato të klientëve, po ashtu ka deklaruar se në dyqane ka të instaluar sistemin e kamerave dhe

kohë pas kohe i shikon ato dhe në një rast klienti i thotë se a bënë më lirë mirëpo në dyqan është sistemi i cili në momentin që ia tregon barkodin automatikisht e qet çmimin dhe duke i shikuar kamerat njëri nga të akuzuarit mallin e vlerës 36 euro e shet në vlerë prej 50 me që rast i njëjti diferencën pre 14 euro e merr për veti, më tutje i njëjti ka deklaruar se me një rast tjetër i akuzuari Leutrim i thotë se një mall kushton 75 euro ndërsa e ka faturuar në vlerë prej 63 euro, po ashtu i dëmtuari të akuzuarve ua ka bërë me dije se i ka parë duke keqpërdorur dhe se të njëjtëve ua ka dhënë në shikim videot e kamerave të sigurisë se çfarë kanë bërë të njëjti ndërsa shumë e demit e kanë nxjerrë duke u bazuar në raportin e stokut që është diku në vlere rreth 6000 euro, në dyqanin e tij ekzistojnë dy libra të shitjes njëri është libri i shitjes ndërsa tjetri libri i kacës, këto libra mund të mos përputhen nëse ndonjë klient merr borxh, po ashtu dëshmitari ka deklaruar se të akuzuarit mallin e tij personit fizik ia kanë shitur me çmim të personit fizik ndërsa kur e kanë faturuar me çmim të personit juridik dhe dallimin në mes këtyre çmimeve e kanë futur në xhep dhe se ka pasur ankesa nga ana e klientëve pasi që po ka dallime në çmime.

## 2.2 Deklarata e dëshmitarit S.H.

Dëshmitari S.H. seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se e din se për cilin rast gjendet në gjykatore dhe se në fazën e hetimeve i ka intervistuar dy të akuzuarit mirëpo nuk i kujtohet se çfarë kanë deklaruar të akuzuarit dhe dëshmitarët dhe me sa i kujtohet e ka bërë hartimin e kallëzimit penal, më tutje dëshmitari ka deklaruar se me sa e din në subjektin juridik të të dëmtuarit është folur se mekanikët e kanë një përqindje më të lirë për blerjen e mallit dhe se nuk e din nëse F. J. ka qenë në mesin e tyre dhe se mbetet në tërësi pranë të gjitha shkresave të deponuara, po ashtu i kujtohet se e ka intervistuar të dëmtuarin F. R. mirëpo nuk i është kujtuar se çfarë vlere të mallit i njëjti e ka përmendur.

## 2.3 Deklarata e dëshmitarit F. J.

Dëshmitari F. J. seancë e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se e din se për cilin rast gjendet që gjykatore dhe se për këtë rast ka dhënë deklaratë në polici dhe mbetet pranë saj, më tutje dëshmitari ka deklaruar se është e vërtetë se me datën 14.10.2018 tek lokali i cili është objekti për të cilin ishte në gjykatore i kishte blerë dy amortizera dhe gurtne në vlerë prej 100 euro, të njëjtit nuk iu është kujtuar nëse për këto pjesë i është bërë zbritje apo jo dhe për këtë mall të nesërmen është pajisur me faturë dhe se këtë shitje ai kishte bërë E. D., amortizerat i është dashur që ti ndërroj dhe se kishte shkuar automekaniku për ti ndërruar dhe se shitësi ia kishte dhënë një faturë prej 100 eurove dhe se nuk i kujtohet se a ka qenë fatura në emrin e tij mirëpo shuma ka qenë në rregull, më pas automekaniku Arben e ka pyetur nëse e ka marrë dallimin sepse amortizerat e pasme kushtojnë më lirë i njëjti kishte deklaruar që jo dhe e kishte udhëzuar mekanikun që për punën që e ka kryer ta merr dallimin, po ashtu i njëjti ka shtuar se nuk e ka shikuar se në emër të kujt është fatura ndërsa ka blerë mall në vlerë prej 100

euro dhe se 100 euro ka qenë vlera edhe në faturë dhe se kjo faturë nuk ka qenë kupon fiskal por ka qenë e formatit A4 ku janë precizuar lloji i amortizerave, gurtet dhe çmimi dhe se për dallimin pas nderimit të pjesëve është kompensuar nga pronari në vlerë prej 20 euro mall dhe se asnjëherë A...-mekaniku nuk i kishte thënë që të shkoj ai t'ia blejë pjesët ngase ia lënë më lirë.

#### 2.4Mbrotja e të akuzuarit E. D..

I akuzuari E. D... në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në lokalin "A. P. P." Sh.p.k në Gjilan ka punuar rreth 2 vite nga mesi i vitit 2016 deri me 13 janar 2019, dhe se aty kishte punuar si punëtor i thjeshtë dhe se nuk kishte pasur ndonjë të drejtë sikur që e kanë menaxherët por është marrë vetëm e me shitjen e mallit, dhe sa ka punuar aty ka dalë edhe në teren për vizita tek klientët ndërsa me mall kanë qanë të ngarkuar punëtorët por jo me emra të përveçëm po ashtu i njëjti ka shtuar se ka punuar në këtë lokal ka arritur që ti bëjë dy regjistrime të fund vitit dhe se në barazim nuk kishin pasur vërejtje, po ashtu i njëjti ka deklaruar se në ditën kur është larguar nga puna nuk e kanë lajmëruar fare që do ta largojnë dhe po ashtu se në atë kohë nuk është bërë regjistrimi i mallit. Ndërsa në regjistrimin e mallit të datës 29.01.2019 i njëjti nuk ka marrë pjesë pasi nuk kishte qenë i ftuar. Më tutje i njëjti ka deklaruar se procesi i shitjes ishte bërë në mënyra të ndryshme p.sh.: nëse e ka ardhur në klient i cili nuk ka qenë mekanik dhe ia ka përmendur emrin e ndonjë mekaniku i akuzuari automatikisht ia ka faturuar mallin e atij mekaniku dhe përqindja iu është zbritur nga borxhi që e ka pasur mekaniku, po ashtu aty kanë punuar me një program dhe secili punëtor ka punuar me user të vetin për shkaqe të sigurisë dhe se ky program ishte bërë nga një kompani private. Më tutje ka deklaruar se ofertat kanë qenë lloj tregtie në mes kompanisë dhe klientëve, i njëjti ka deklaruar se pro fatura ishte bërë në dritaren e kompanisë ndërsa fatura tatimore ishte bërë në dritaren tjetër dhe ka hyrë në librin e shitjes për ATK-ën, ku i ishte bashkangjitur nënshkrimi, vula dhe kuponi fiskal, ndërsa fatura me pro faturën nuk ishin përputhur për arsye se kanë qenë të obliguar nga i dëmtuari që të përpjesëtohen në % nga pro fatura në faturë tatimore dhe se kjo përqindje ka qenë e llojeve të ndryshme, ndërsa malli i vlerave më të mëdha kishte pasur përqindje më të madhe. Gjatë dhënies në shikim nga mbrojtësi i tij të një pro fature e cila nuk kishte kupon fiskal në vlerë prej 142.60 cent i akuzuari kishte deklaruar se kjo pro faturë kur ishte bartur në dritaren tjetër është bërë faturë tatimore në vlerë prej 114.08 cent me kupon fiskal të cilës iu kishte bashkangjitur, dhe arsyeja e këtij dallimi kishte qenë përpjesëtim të cilin e kishin detyruar i dëmtuari që ta bënin përpjesëtimin e shumës e cila është në pro faturë për ta bërë zbritjen në mënyrë të rregullt për ta deklaruar në ATK dhe se në kompani e kanë pasur librin e kacës në të cilin ku ishin bërë të gjitha shpenzimet dhe shitjet ndërsa tek libri i arkës ishin bërë vetëm inkasimit të cilat janë bërë në mënyrë reale, dallimi ishte bërë sepse inkasimi ka qenë më i madhe ndërsa në arkën reale ka qenë më i vogël dhe se paratë që kanë qenë të inkasuar në mënyrë të rregullt i njëjti i kishte dërguar personalisht në bankë ndërsa dallimin tjetër ia kanë dërguar të dëmtuarit me zarf. Gjithashtu i njëjti ka deklaruar se në këtë program kishin pasur qasje pronari dhe menaxheri dhe kohëve të fundit



kishin pasur presion pasi që ishte rritur konkurrenca, dhe se i dëmtuari gjatë gjithë kohës i kishte ndërruar punëtorët dhe të njëjtin e kishin larguar kinse për shkak të keqpërdorimeve në këtë kompani, po ashtu i njëjti ka deklaruar se me pronarin ka pasur raporte të mira deri sa në ditën kritike kur menaxheri i kompanisë i kishte thënë që duhet ta presin pronarin dhe aty kishin ndryshuar të gjitha gjërat, i njëjti më tutje ka deklaruar se pronari i kishte thënë që të shkojnë tek noteri për t'ia kompensuar dëmin mirëpo i njëjti nuk kishte pranuar pasi i kishte thënë se nuk ka bërë asgjë, i njëjti ka deklaruar se nuk e ka ditur që babi tij e ka ftuar në telefon të dëmtuarin për tu takuar por këtë e kishte kuptuar më vonë dhe se nuk e ka ditur arsyen pse babi i tij ka dashur që të takohet me të dëmtuarin, më tutje i akuzuari ka deklaruar se i kishin vizituar klientët e tyre për arsye se a kishin nevojë për produkte dhe pse nuk po bëjnë blerje më dhe iu kishin treguar ofertat e reja, ndërsa kur ishin barazuar në fund të orarit në librin e kacës dallimet në mes inkasimit dhe deklarimit në librin e shitjes kishte pasur mundësi të kishte qenë minimal + - 1 euro, po ashtu i njëjti në fund ka deklaruar se i dëmtuari me një ish menaxher kishin ardhur në Gjilan dhe i kishin kërkuar takim mirëpo i njëjti iu kishte thënë se këtë çështje do ta zgjidhin në gjykatë.

#### 2.4.Mbrojtja e të akuzuarit L. K.

I akuzuari L.K. në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në kompaninë “A.. P. P...” Sh.p.k punën e kishte filluar nga data 13.07.2018 ku fillimisht kishte punuar si agjent i shitjes ndërsa pas datës 01.08.2018 kishte filluar të punoj si shitës dhe për të mësuar rreth programeve dhe sistemeve të kësaj kompanie dhe se në 3 mujorin e parë ishte marrë me dorëzimin e pajisjeve tek klientët dhe me vendosjen e pjesëve në rafte e depos, i njëjti më tutje ka shtuar se kur ka filluar të punoj nuk është bërë ndonjë numërim i stokut dhe se nuk ishte lajmëruar se nëse në të ardhmen do të ketë ndonjë mungesë do të akuzohet për një mungesë të tillë. Po ashtu ka deklaruar se kishte bërë shitjen e mallit dhe se për këtë gjë kishte pranuar para dhe se barazimet i kishin bërë në fund të orarit, përmes një dritare e quajtur “A..e sh..” dhe e gjithë shuma e deklaruar në atë dritare ishte transferuar përmes në kartelet bankare e cila ka qenë në emër të E. D. ndërsa diferenca e shumës e cila kishte qenë në dritaren tjetër të quajtur “në të Z..” është bartur me një zarf dhe paragon përmes shoferit tek kompania kryesore. Më tutje i akuzuari ka deklaruar se kanë mundur ti shesin produktet edhe nëse pagesa nuk është bërë menjëherë dhe mekanikët në raport me personat fizik kanë pasur një përpjesëtim ose ndryshim çmimi dhe nëse ka ardhur një person fizik për të blerë ndonjë pjesë dhe e kishte cekur se cili mekanik e kishte dërguar atëherë ajo diferencë iu është zbritur mekanikut. I akuzuari ka deklaruar se kishte pasur raste kur parat e tija ua kishte kthyer për kusur klientëve sepse nuk kishte pasur para në kacë dhe kjo gjë kishte ndodhur disa herë, po ashtu i njëjti ka deklaruar se në ditën kur është larguar nga puna së bashku me menaxherin P.. S.. i kishin pyetur mekanikët se a kishin vërejtje rreth shumës së borxhit dhe mekanikët iu kishin thënë se nuk kanë ndonjë vërejtje apo ankesë dhe se nuk ka qenë prezent kur është bërë regjistrimi i mallit me datë 27.01.2019, po ashtu i akuzuari ka deklaruar se me

pronarin e kompanisë si dhe me menaxherin nuk kanë pasur raporte të këqija dhe se nuk e din arsyen se pse ishte larguar nga puna, me tutje i njëjti ka deklaruar se në tre mujorin e parë ishte marrë me bartjen e mallit tek mekanikët se në shumicën e rasteve mekanikëve nuk iu është bashkangjitur fatura kur iu është bërë dorëzimi i mallit tek ata. I akuzuari e ka pohuar se ish kolegu i tij A.. e kishte thirrur të dëmtuarin në telefon për tu takuar që të mos shkoj lënda në gjykatë dhe se kjo kërkesë nuk ishte personale mirëpo për shkak të shqetësimit të familjes për t'i mos penguar në studime edhe pse nuk e ndjente vetën fajtor mirëpo nuk kishte hasur në mirëkuptimin e të dëmtuarit dhe se ishte e vërtetë që kishte qenë në fshatin K. mirëpo nuk kishte qenë në pikën kryesore të kompanisë. Në fund i akuzuari ka deklaruar se programi kishte pasur dy dritare ku deklarimi real është bërë në dritaren nga ana e shtetit ndërsa në dritaren në të zezë ka qenë diferenca e çmimeve si dhe ka pasur raste kur mekanikëve iu është dorëzuar pro fatura dhe se në dritaren e shtetit janë deklaruar faturat tatimore ku është bërë edhe përqindja e zbritjes që kanë pasur mekanikët , po ashtu ka pasur dallim në mes faturës tatimore të deklaruar në të shtetit dhe pro faturës lidhur me çmimin, pro faturat kanë shërbyer për anën e dritares në të zezë por nuk e dinte rendësin e tyre dhe se vlera e saktë e mallit të shitur është shkruar në pro faturë me të cilën më së shumti janë bërë shitjen dhe nuk e dinte arsyen se pse.

### 3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata komfor nenit 7 të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka ardhur në përfundim se mbrojtjes së të akuzuarve të dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk duhet ti falet besimi ngase të njëjtat nuk janë në harmoni të plotë me provat e tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër nga ajo për të cilën të akuzuarit kanë pretenduar.

Pas administrimit të provave personale dhe materiale gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike nuk ishte kontestues fakti se të akuzuarit E. D.. dhe L. K. kishin qenë të punësuar tek subjekti afarist “A. P. P” Sh.p.k e cila në kuadër të veprimtarisë së saj biznesore merret me shitblerjen e pjesëve të automjeteve ngase një fakt i tillë përveç që nuk është mohuar nga të akuzuarit e as nga i dëmtuari është vërtetuar edhe nga kontratat e punës të lidhura ndërmjet “A.P. P.” Sh.p.k dhe E. D. e datës 01.08.2017 dhe “A. P. P.” Sh.p.k dhe L.K. e datës 01.10.2018, po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti se ky subjekt afarist në kuadër të shitjeve të pjesëve kishte dy lloje të çmimeve të tjera për personat juridik dhe të tjera për personat fizik sepse një fakt i tillë është vërtetuar nga vet deklarata e të dëmtuarit e po ashtu

edhe nga vet deklaratimet e të akuzuarve mirëpo kontestuese në këtë çështje penalo juridike ishte fakti nëse të akuzuarit me veprimet e tyre kishin keqpërdorur autorizimet e dhëna me qëllim të realizimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për veten e tyre përkatësisht nëse të akuzuarit kishin shitur pjesë me çmim më të lartë ndërsa shitjen e kishin faturuar me çmim më të ultë dhe diferencën e këtij çmimi e kishin marrë për vete por gjykata këtë fakt kontestues e zgjodhi së pari duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit të cilës ia falë besimin në tërësi i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se të akuzuarit E.D. dhe L. K. gjatë kohës sa kishin qenë të punësuar në biznesin e tij kishin shitur pajisjet e automjeteve me çmim më të shtrenjtë se sa ato në të vërtetë ishin ndërsa i kishin faturuar me çmim më të ultë dhe diferencën mes shitjes dhe faturimit e kishin marrë për veten e tyre ku në këtë mënyrë kishin dëmtuar klientët e biznesit të tij dhe vet atë, deklaratë kjo e cila është në përputhje edhe me deklaratën e dëshmitarit F. J. të cilit po ashtu gjykata ia falë besimin në tërësi i cili kishte deklaruar se me datë 14.10.2018 tek lokali në fjalë kishte blerë dy amortizera dhe gurtne në vlerë prej 100 euro, të cilën shitje e kishte bërë E. D. por që këto pajisje i kishte marrë gabim dhe se të njëjtat duhej që të ndërroheshin ashtu që kishte shkuar për ti ndërruar ku më pas i akuzuari E. D. i kishte dhënë një faturë në formë A4 e cila nuk kishte qenë kupon i rregullt fiskal në të cilën kishte faturuar këto pajisje në shumën prej 100 € ashtu që më pas dëshmitari F. J. kishte shkuar tek automekaniku i cili e kishte pyetur nëse ai e kishte marrë dallimin e parave nga ndërrimi i këtyre pajisjeve pasi që me rastin e ndërrimit të tyre duhej që ti kthehej një shumë e caktuar e të hollave sepse pjesët e marra për herën e dytë kushtonin më lirë se sa to që i kishte marrë herën e parë por që dëshmitari F.. i kishte treguar automekanikut se nuk e kishte marrë këtë diferencë, deklarata këto të cilat janë në përputhje edhe me faturat e administruara nga ana e gjykatës dhe mbi të gjitha ky fakt kontestues nga ana e gjykatës është zgjidhur duke u bazuar në faturat tatimore të administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor ku nga fatura tatimore me numër F....., rezulton se klienti kishte paguar shumën prej 57.50 € ndërsa shitja ishte faturuar në shumën prej 39.47 € pastaj nga fatura me numër F.....rezulton se klienti kishte paguar shumën prej 100 € ndërsa kjo shitje ishte faturuar në vlerën prej 82.99 €, një fakt i tillë është provuar edhe nga shikimi i CD me video incizim e datës 19.01.2019 ku evidentohet i akuzuari L.. K.. duke bërë shitjen e disa pajisjeve në vlerë prej 30 euro ndërsa në faturë rezulton të jetë çmimi në shumën prej 28.79 € pastaj në një rast tjetër i njëjti bën shitje në vlerë prej 9 € ndërsa e faturon në vlerën prej 7.65€, pastaj një shitje tjetër në vlerë prej 50 € të cilën e faturon në vlerën prej 43.56 €. Se me të vërtetë të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen secili prej tyre veç e veç pjesërisht vërtetohet edhe nga vet deklaratat e të akuzuarve të dhëna në polici ku ndër të tjera i akuzuari E.. D.. në pyetjen se ....ju keni shitur pjesë të veturave me çmim më të lartë e i keni faturuar me çmim më të ultë çka mund të na thuash për këtë? i njëjti ishte përgjigjur *“Kjo ka pas mundësi me ndodh pasi që tek auto pjesa në fjalë ka qenë katër kategori të çmimeve, po asnjë moment me qëllim të caktim unë se kam një veprim të tillë... por edhe nëse ka ndodh ka përfutuar firma,”* pastaj në pyetjen se a ka pas rast raste kur ka ndodh që keni marr para më shumë nga klienti për një pjesë dhe e keni faturuar më pak? I njëjti ishte përgjigjur *“Ka mundësi por pa vetëdije nga gabimi teknik apo ndërrimi i pjesës”*, pastaj në pyetjen se a

ke njohuri për një rast kur një klienti ja merrni 4 euro më shumë? I akuzuari ishte përgjigjur *“Po kam njohuri sepse drejtori i firmës F.. R.. ma ka prezantuar me video.....këtu mendoj se kam gabuar pasi që klienti ka kthyer disa herë pjesët sa ka qenë në lokal.....”* gjithashtu i akuzuari L.. K.. në deklaratën e tij të dhënë në polici kishte deklaruar *“...vlen të ceket një rast kur një person ka blerë një bravë të derës së veturës g.... e cila normal kushton 4 € për mekanikët e unë ja kam inkasuar 4.5 €....”, “.... kam shitur një bateri 55AH magneti marelli në vlerë prej 46.74 € të cilën kam harruar ta faturtoj dhe nga ana ime nuk është barazuar kaca në fund të ditës.....”* andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në atë se të akuzuarit sipas kontratave të punës të lidhura me të dëmtuarit dhe atyre ata kanë qenë persona të autorizuar për ti përfaqësuar interesat e të dëmtuarit dhe si rrjedhojë i kanë keqpërdorur autorizimet e tyre që rrjedhin nga këto kontrata me qëllim që vetit ti sjellin dobi pasurore të kundërligjshme gjykata erdhi në përfundimin se në veprimet e të akuzuarve E. D.. dhe L..K.. formësohen elementet e veprës penale keqpërdorimi i besimit nga nenit 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës për të cilat të njëjtit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve E.. D.. dhe L... K.. mirëpo gjykata mbrojtjet e tilla nuk mundi ti pranojë për faktin se të njëjtat janë në kundërshtim të plotë me gjitha provat personale dhe materiale të administruara nga ana e gjykatës përfshirë edhe vet deklarata e tyre të dhëna në polici dhe të njëjtat i konsideroi si të pabazuara në prova dhe të dhëna drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Sa i përket provave materiale si 5 faturat tatimore ( të propozuara nga mbrojtja), libri i kacës, libri i arkës, emailt e dërguara nga pronari- i dëmtuari tek të akuzuarit me udhëzimet se si të veprohet me çmime, raportin informues të incidentit dhe raportin zyrtar të oficerit gjykata pas vlerësimi dhe analizimit të tyre konsideron se të njëjtat nuk kanë ndonjë relevancë në drejtim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike për faktin se raporti informues i incidentit dhe raporti i oficerit përshkruajnë veprimet hetimore të marra nga ana e policisë ndërsa provat materiale të propozuara nga mbrojtja si 5 faturat tatimore, libri i kacës, libri i arkës, emailt e dërguara nga pronari- i dëmtuari tek të akuzuarit me udhëzimet se si të veprohet me çmime të njëjtat nuk kanë të bëjnë me objektin e akuzës por janë në drejtim të mënyrës së veprimit dhe zbatimit të kontabilitetit në kompaninë e të dëmtuarit.

Lidhur me propozimin e mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit L.. B.. i cili sikur të akuzuarit kishte punuar tek kompania e të dëmtuarit dhe me qëllim të tregimit të faktit se kompania e të dëmtuarit ka aplikuar standarde të dyfishta të kontabilitetit gjykata një propozim të tillë nuk e kishte aprovuar për faktin se standardet e kontabilitetit të cilat i ka aplikuar kompania e të dëmtuarit nuk ishte objekt i akuzës por objekt i akuzës dhe i njëjti nuk kishte se çfarë të dëshmonte në drejtim të veprimeve të të akuzuarve, po ashtu gjykata ka refuzuar edhe propozimin e mbrojtjes për administrimin si provë të një CD për faktin burimi i kësaj prove ishte i panjohur, nuk dihej origjina e saj ashtu siç kërkohet me

dispozitat e KPP-ës ndërsa gjykata kishte aprovuar propozimin e mbrojtjes për administrimin e e 3 faturave tatimore mirëpo siç është cekur më lartë të njëjtat nuk kishin ndonjë relevancë në këtë çështje penalo juridike për faktin se ato kishin të bëjnë me mënyrën e veprimit dhe zbatimit të kontabilitetit në kompaninë e të dëmtuarit.

#### 4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se:

- I akuzuari E.. D.. ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga nenit 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
- I akuzuari L.. K.. ka kryer veprën penale keqpërdorimi i besimit nga nenit 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve duhet ti shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ku mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve e cila nga provat materiale të administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor del të jetë e lartë meqenëse të akuzuarit me rastin e kryerjes së veprave penale secili prej tyre kanë qenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe veprat penale i kanë kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, parasysh sjelljen e mëparshme të kryesve, rrethanat personale të tyre si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarit mori rrethanat personale karakterin e tyre për faktin se për njëjtë kjo ishte hera e parë që bien ndesh me ligjin përkatësisht më parë të njëjtë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, pasta bashkëpunimin e përgjithshëm me organet

e ndjekjes si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale për faktin se të njëjtit me të dëmtuarin pas këtij rasti më nuk kanë pasur probleme ndërsa si rrethanat rënduese për secilin prej të akuzuarve gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del secili prej tyre veprat penale i kanë kryer me dashje dhe atë direkte sepse e kanë ditur se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj ata e kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e saj ashtu siç përshkruhet në pikat I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethana rënduese për të akuzuarit gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tyre për kryerjen e veprave penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik po ashtu edhe nga provat e çështjes del se të njëjtit duke keqpërdorur besimin e dhënë nga i dëmtuari përmes kontratave të shkruara ata kanë keqpërdorur autorizimet e tyre dhe në mënyrë të vazhdueshme kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme duke shitur pjesë të automjeteve me çmim më të lartë ndërsa duke e faturuar me çmim më të ultë andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata të akuzuarve u shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të tyre mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 6. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Duke pasur parasysh se si provë është administruar edhe aktvendimi mbi regjistrimin e mallit i datës 27.01.2019 ku i dëmtuari pretendon se dëmi i shkaktuar nga të akuzuarit kap vlerën prej 6065.00 € gjykata konsideron se përkundër administrimit të saj si provë e njëjta nuk ofron bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën F... R.. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit ti obligojë secilin veç e veç që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.288/2019 me datë 24.09.2021

Zyrtarja Ligjore,  
gjykues,  
Eronita Llapashtica  
Sermaxhaj

Gjyqtari i vetëm  
  
Rilind

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.